



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:202408

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05488071

Ac.nr.413/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësve F. H. dhe S. H., që të dy nga M., që sipas autorizimit përfaqësohen nga Xh. B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “B. Ko. e S.” (BKS), me seli në P., të cilën e përfaqëson me autorizim O. H., në çështje juridike të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësi e po ashtu edhe sipas ankesës së ushtruar nga i padituri, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 2800/19 të datës 14.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT ankesa e paditësve F. H. dhe S. H., që të dy nga M. dhe ankesa e të paditurës “B. K. e Si.” (BKS), me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET PJESËRISHT** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.2800/19 i datës 14.01.2021, sa i përket pikës **I** të dispozitivit të tij, lidhur me gjykimin e rrjedhjes së kamatëvonesës në shkallë prej **8% vjetore**, sa i përket dëmit material dhe jo material, dhe lidhur me këtë, **gjykohet** si në vijim:

II.DETYROHET e paditura B. K. e Si.(BKS), me seli në P., që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, paditësve F. H. dhe Se. H., që të dy nga M., si në pikën **I** të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, t’ua paguajë me kamatë ligjore prej **8% vjetore**, e cila kamatë sa i përket dëmit material fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë **18.02.2014**, ndërsa sa i përket dëmit jo material, kamatëvonesa prej 8% vjetore, fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, para kthimit të lëndës në rigjykim dhe atë me numër **C. nr. 522/14, dt: 06.09.2017**, e gjer në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.

III. Pjesa tjetër e ankesës së paditësve F. H. dhe S. H., që të dy nga M., ushtruar përmes të autorizuarit të tyre X. B., avokat nga Prishtina, si dhe ankesa e të paditurës B. K. e S. me seli në P., **REFUZOHEN SI TË PA BAZUARA**, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.2800/19 i datës 14.01.2021, sa i përket pikës **I** dhe **II** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm me aktvendimin e ankimuar C.nr.2800/19 të datës 14.01.2021, ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve F. H.dhe S. H. nga M., ashtu që DETYROHET e paditura “Byroja Kosovare e Sigurimeve”, me seli në Prishtinë, që paditësve, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, të pësuar në aksidentin e trafiku në Prishtinë të ndodhur më datën 27.02.2013, t’ua paguaj shumat si vijon:

Paditësit F. H., në emër të kompensimit të *dëmit jomaterial*:
për dhimbjen fizike-trupore, shumën prej 1,200.00 euro,
për frikën e përjetuar, shumën prej 700.00 euro,
në emër të kompensimit të *dëmit material*:
për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, shumën prej 40.00 euro,
për ushqim të përforcuar, shumën prej 60.00 euro.

Paditëses S.H., në emër të kompensimit të *dëmit jomaterial*:
për dhembje fizike-trupore, shumën prej 1,500.00 euro,
për frikën e përjetuar, shumën prej 1,000.00 euro,
në emër të kompensimit të *dëmit material*:
për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, shumën prej 120.00 euro,
për ushqim të përforcuar, shumën prej 60.00 euro.

Për të dy paditësit kamatën ligjore në lartësi prej 8% në shumat e lartë cekura nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, si dhe në emër të shpenzime të procedurës në shumë 1,224.80 euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm;

II.REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e gjykuara dhe atë: për paditësin F.H., për dhimbje fizike, për shumën 1,300.00 euro; për frikë për shumën prej 1,300.00 euro; për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj për shumën 30.00 euro; për ushqim të përforcuar për shumën prej 20.00 euro, për rehabilitim fizioterapeutik, shumën 75.00 euro; për paditësen S. H., për dhimbjen fizike për shumën 500.00 euro, për frikë për shumën prej 1.600 euro; për ushqim të përforcuar, për shumën prej 30.00 euro, për rehabilitim fizioterapeutik shumën 180.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë kanë paraqitur paditësit, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e

paditësve ashtu siç është kërkuar në precizim të kërkesëpadisë me kamatë ligjore prej 8% duk e llogaritur nga data 06.09.2017.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka paraqitur po ashtu e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të themeltë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar ashtu që përtej shumës së propozuar nga e paditura për kompensimin e dëmit, kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas ekzaminimit të ankesës së të paditurës së dytë, shqyrtimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 195 par.1, pika d) dhe e), në lidhje me nenin 200, dhe 201, pika d), të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësve është pjesërisht e themeltë.

Ankesa e të paditurës është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit F.dhe S. H. nga M., përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar Xh. B., avokat nga Prishtina, me datë 18.02.2014 kanë ushtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve” (BKS), me seli në Prishtinë për kompensim dëmi si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 27.02.2013. Pjesëmarrës në aksident kanë qenë, në njërin anë, drejtuesi i automjetit të tipit M.B., me targa të regjistrimit 02-160-AS, të cilin e drejtonte paditësi F. H., ndërsa në anën tjetër, drejtuesi i automjetit Opel Zafira, me targa të regjistrimit MBC4-18Z. Deri te aksidenti kishte ardhur me lëshimet e drejtuesit të automjetit Opel Zafira. E paditur u kishte paraqitur ofertë për ujdje jashtë gjyqësore, porse për paditësit, shumat që janë ofruar nga e paditura nuk kanë qenë të pranueshme. Përmes parashtrësës së datës 05.07.2017 pas nxjerrës së ekspertizës mjekësore, paditësit e kanë precizuar kërkesëpadinë duke i propozuar gjykatës që ta aprovojë kërkesëpadinë si të themeltë për të gjitha format e dëmit material dhe jo material. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, dhe atë të gjitha shpenzimet që janë aprovuar sipas Aktgjykimit C.nr.522/14 të datës 06.09.2017 të kësaj gjykate, si dhe për dy seanca të mbajtura në procedurë të rigjykimin në vlerë prej 404.00 euro për të dyja, e në total në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, shumën prej 1,222.00 euro.

E paditura, përmes përgjigjes e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve për sa i përket bazës juridike por edhe të lartësisë me arsyetimin se padia nuk përmban prova sa i përket shpenzimeve të shërimit eventual të paditësve, si dhe se nuk ka prova të mjaftueshme sa i përket natyrës së lëndimeve që kanë pësuar paditësit në këtë aksident dhe se paditësve u ka paraqitur ofertë për arritje të marrëveshjes jashtëgjyqësore duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë si të pabazuar përtej shumave që janë ofertuar nga e paditura. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Me Aktgjykimin C.nr.522/14, të datës 06.09.2017, të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve, për shumat e cekura si në këtë Aktgjykim. Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vepruar sipas ankesave të paraqitura nga të dyja palët ndërgjyqëse, me Aktvendimin Ac.nr.5677/17, të datës 02.08.2019,

kishte kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje, duke gjetur se të autorizuarit të palëve paditëse, në shkresat e lëndës, i mungon autorizimi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësve dhe sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat, e pas vlerësimit të tyre ka marr aktgjykimin e atakuar C.nr.2800/19, të datës 14.01.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitiv të tij.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjygjëse nuk është kontestues fakti se me datë 27.02.2013, si pasojë e aksidentit të trafikut në mes të automjetit M. ku drejtues ishte paditësi F. H. dhe automjetit O.Z. për shkak të lëshimeve të drejtuesit të automjetit O.Z., lëndime trupore kanë pësuar paditësit, fakt ky i vërtetuar nga Raporti i Qendrës Emergjente, dokumentacioni mjekësor dhe ekspertiza mjekësore e dr. Vjollca Bince ortoped dhe dr. Samire Braina psikiatër. Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë, praktikën gjyqësore dhe mendimit të eksperteve dr. Vjollce Bince dhe dr. Samire Braina psikiatër, ashtu që aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke i gjykuar shumat si në vijim: për paditësin F.H., për dhimbjen fizike-trupore, shumë prej 1,200.00 euro, për frikën e përjetuar, shumë prej 700.00 euro, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, shumë prej 40.00 euro, për ushqim të përforcuar, shumë prej 60.00 euro. Paditëses S.H., në emër të kompensimit të dëmit për dhembje fizike-trupore, shumë prej 1,500.00 euro, për frikën e përjetuar, shumë prej 1,000.00 euro, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj, shumë prej 120.00 euro, për ushqim të përforcuar, shumë prej 60.00 euro, duke e bazuar vendimin e saj në nenin 136,137,140,159, nenin 183 të LMD, si dhe neni 323 të LPK-së. Për sa i përket kamatës ligjore gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i qëndrueshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar edhe pse nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, mirëpo, sa i përket momentit të rrjedhjes së kamatë vonesës e drejta materiale është zbatuar gabimisht, për çka aktgjykimi është dashtë të ndryshohet sa i përket kësaj pjese dhe të vendoset si në dispozitiv të akrgjykimit të lart cekur.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur për shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), pasi që arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së, meqë gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet e çështjes, për provat të cilat i ka shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe për vlerësimin e tyre. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke

qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit ka paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësve (baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve ndërgjyqjese, për më tepër me e paditura kishte ofruar shumën e caktuar për kompensim dëmi përmes ujdisë jashtëgjyqësore, rrjedhimisht kontestues ishte vetëm lartësia e saj), e cila është provuar përmes ekspertizës mjekësore, lëndimin dhe pasojat për paditësit, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara, për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësit.

Gjithashtu, edhe pretendimi i palës së paditur për konstatim jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike nuk qëndron ngase, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket konstatimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të ligjit material. Duke shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësve dhe të paditurës lidhur me vërtetimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata e Apelit vlerëson se janë pretendime ankimore të paqëndrueshme dhe pabazuara, pasi e paditura gjatë procedurës nuk e kishte kontestuar kërkesëpadinë për nga baza dhe e njëjta është e provuar edhe me prova materiale. Ndërkaq, edhe pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqjese lidhur me lartësinë e shumave të aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për kompensimin e dëmit jo material dhe material si shuma tepër të larta sipas të paditurës, ndërsa të ulëta sipas paditësve dhe jo në harmoni me natyrën e lëndimeve të pësuar, gjykata e shkallës së dytë i vlerëson si të paqëndrueshme dhe të pabazuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shumat në bazë të vlerësimeve profesionale të ekspertëve mjekësor në ekspertizat e tyre të cilët kanë konstatuar lëndimet e pësuar nga paditësve sa i përket dëmit material dhe këto shuma janë në harmoni edhe me nenin 136, 169, 173 dhe 174 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe në harmoni edhe me Udhëzuesin e nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 41/23, dt: 27.02.2023, lidhur me parametrat vlerësues dhe lartësinë orientuese të kompensimit lidhur me dhimbjet fizike, frikën dhe kategoritë tjera për dëmin material dhe jo material. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe në bazë të nenin 323 të LPK-së, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili shprehimisht parasheh “*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u*

shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëro”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast palët paditëse kanë pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, si dhe rrethanat tjera, praktikën gjyqësore, rezulton se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Si rrjedhojë, Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe në harmoni edhe me praktikën gjyqësore të gjykatave të Kosovës sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë e cila po ashtu është vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, e cila konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e Gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se palët e dëmtuara kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë (për kohën e cekur në ekspertizë) atëherë vërtetohet se palëve të dëmtuara u takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për bazueshmërinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësve është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo-juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur themelësia e kërkesëpadisë së paditësve, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësve në rastin konkret është pjesërisht e themeltë. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Gjithashtu, sa i përket vlerësimit të pretendimeve ankimore të palës paditëse lidhur me shumat e gjykuara të kompensimit të dëmit material dhe jo material si në pikën I të dispozitivit, të njëjtat pretendime janë të pa bazuara ngase duke marrë për bazë natyrën e lëndimeve që paditësit kanë pësuar nga ky aksident i komunikacionit të cilat janë kategorizuar si lëndime të lehta trupore, me pasoja e përshkruara dhe konstatuara përmes ekspertizave mjekësore nga gjykata e shkallës së

parë, atëherë, gjykata e shkallës së dytë, duke iu referuar neneve 136, 169, 173 dhe 174 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe në harmoni edhe me Udhëzuesin e nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 41/23, dt: 27.02.2023, lidhur me parametrat vlerësues dhe lartësinë orientuese të kompensimit lidhur me dhimbjet fizike, frikën dhe kategoritë tjera për dëmin material dhe jo material. Andaj, për këtë gjykata e shkallës së parë me të drejtë është bazuar në dispozitat e nenit 183 të Ligjit nr.04/L077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, por edhe në bazë të nenin 323 të LPK-së, si dhe kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e sidomos duke pasur parasysh shkallën e dhimbjeve fizike dhe frikës, për çka edhe Gjykata e Apelit i ka vërtetuar shumat e kompensimit të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjatë vendosjes lidhur me to, gjykata e shkallës së parë, është mbështetur siç duhet në nenin 183, par. 2 të LMD-së, i cili shprehimisht parasheh “*Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëro*”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast palët paditëse kanë pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë, për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, si dhe rrethanat tjera, praktikën gjyqësore, rezulton se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësi, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla

Megjithatë, Gjykatës së Apelit, i rezultojnë të bazuara pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me momentin e rrjedhjes së kamatë vonëses lidhur me caktimin e kompensimit të dëmit material dhe jo material nga ana e gjykatës së shkallës së parë ashtu që, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën material respektivisht nenin 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe Mendimin Juridik për kamatën të miratuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës me numër protokollit 265/2020 të datës 02.12.2020 për sa i për sa i përket llogaritjes së kamatës tek dëmin material dhe jo material në pikën XIV dhe XV të këtij mendimi parasheh se “Lidhur me dëmin material, “kamatëvonesa fillon të rrjedhë nga data e ushtrimit të padisë”, ndërsa lidhur me dëmin jo material në pikën e XV-të përcaktohet se “*Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit jo material, kamata fillon të rrjedhë nga data e*

marrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë e deri në pagesën e plotë”, dhe në rastin konkret, dëmi material për paditësit duhet të fillojë të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë 18.02.2014 e tutje, ndërsa kamatë vonesa për dëmin jo material për paditësit fillon të rrjedhë nga data e nxjerrjes së aktgjykimit për herën e parë nga gjykata e shkallës së parë e që është data 06.09.2017, atëherë kur është konstatuar ekzistimi i dëmit jo material, dhe pavarësisht faktit se ky aktgjykim është anuluar nga gjykata e shkallës së dytë, megjithatë ky fakt nuk e zbën momentin e rrjedhjes së kamatëvonesës për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, prandaj, me ndryshimin e aktgjykimit të ankimuar si në dispozitiv të aktgjykimit të lartë cekur, gjykata e shkallës së dytë, gjeti se me zbatimin e drejtë të së drejtës material, duhet vendosur si më lartë.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse,, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 dhe 201, pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 413/22, data 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka